



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2024:015569

Datë: 07.02.2024

Numri i dokumentit: 05298796

P.nr. 10/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Besnik Sheqiri, me procesmbajtëse Erblina Aliu, në çështjen penale kundër të pandehurit I. I., për shkak të veprës penale ne vazhdimësi “Dhuna në familje” nga neni 248 par. 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.757/23F, të datës 15.01.2024, në seancën e shqyrtimit fillestar të mbyllur për publikun, të mbajtur me datë 06.02.2024, në prezencë të prokurorit të shtetit Rukije Sheshivari, të dëmtuarës H. I. dhe të pandehurit, të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 07.02.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

I. I., nga i ati A. dhe nëna N., mbiemri i vajzërisë së nënës Xh., i lindur më ... në fshatin D., Komuna P. ku edhe tani jeton, me numër personal të identifikimit ..., i pa arsimuar, i pa punë, i martuar, baba i katër (4) fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse:

Me datë 27.10.2023, rreth orës 01:00 pas mesnate, por edhe më parë, në vazhdimësi në shtëpinë e tyre në fshatin D., Komuna P., i pandehuri I. I., me dashje dhe me qëllim të cenimit të dinjitetit brenda marrëdhënies familjare ka ushtruar dhunë fizike dhe psikike ndaj të dëmtuarës/dëshmitares bashkëshortes H. I., me të cilën ka katër fëmijë të përbashkët, në atë mënyrë që i pandehuri pasi kishte krijuar dyshime për tradhti bashkëshortore, fillon ta ofendojë të dëmtuarën dhe familjen e saj me fjalët: “oj rraspi, kom met pre, kom met myt”, për ta sulmuar fizikisht duke e kapur për fyti në prezencë të fëmijëve dhe kështu ka vazhduar me ofendime e sharje deri kur e dëmtuara H. I. ka raportuar rastin në polici, në këtë mënyrë tek e dëmtuara/dëshmitarja H. I. është shkakuar ndjenja e frikës dhe rrezikshmërisë personale.

- me këtë ka kryer veprën penale në vazhdimësi “Dhuna në familje” nga neni 248 par. 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të dispozitave ligjore si më lartë dhe neneve 4, 7, 8, 9, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 46, 47, 48, 49 par. 5, 50, 69, 70 të KPRK-së, si dhe neneve 364, 367, 368, 369 dhe 452 par. 4 dhe 462 par. 2 të KPP-së, të pandehurin e:

## GJYKON ME DËNIM ME KUSHT

I. Ashtu që i shqipton Dënim me gjobë në shumë pesëqind (500) Euro dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj, dënime të cilat nuk do të ekzekutohen nëse në periudhën e verifikimit prej një (1) viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale.

II. Gjykata e liron të pandehurin nga detyrimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale, ngase i njëjti është i gjendjes së dobët ekonomike, i pa punë, pa të ardhura tjera, dhe se pagesa e tyre do të rrezikonte gjendjen materiale të tij ose të personave që detyrohet t'i mbështesë materialisht.

III. E dëmtuara H. I., me vendbanim në fshatin D., Komuna P., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko civil.

### A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, ka ushtruar aktakuzën PP/II.nr.757/23F, të datës 15.01.2024, kundër të pandehurit I. I., për shkak të veprës penale në vazhdimësi “Dhuna në familje” nga neni 248 par. 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale, gjyqtari i vetëm gjykues ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 06.02.2024, në të cilën pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit dhe pasi bindet se i pandehuri e kupton aktakuzën, në kuptim të nenit 241 par. 4 të KPP-së, të njëjtit i ka ofruar mundësinë e deklarimit rreth fajësisë - të pranojnë fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar apo të deklarohet të pafajshëm.

I pandehuri në seancën e shqyrtimit fillestar ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar, ka shprehur keqardhje dhe është penduar për veprimet e tij, ka premtuar se në të ardhmen do të jetë më i kujdesshëm dhe nuk do të përsëris veprën penale, tani me bashkëshorten e tij dhe fëmijët e tyre të përbashkët jetojnë në një shtëpi të përbashkët, nga gjykata ka kërkuar shqiptimin e një sanksioni më të butë penal.

Gjyqtari i vetëm gjykues vërteton se i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i pandehuri, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabime faktike, andaj gjatë marrjes në konsideratë të pranimit të fajësisë nga i pandehuri, mori pikëpamjet e prokurorit të shtetit dhe të dëmtuarës.

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë, pranimi i fajësisë është bërë me vullnetin e tij të plotë dhe në pajtim me dispozitat ligjore të KPP-së, andaj ka propozuar që gjykata ta aprovojë pranimin e fajësisë nga i pandehuri, të njëjtin ta shpallë fajtor dhe dënojë sipas ligjit.

E dëmtuara H. I. ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga bashkëshorti i saj tani i pandehuri, nga gjykata ka kërkuar që të njëjtit t'i shqiptojë një sanksion më të butë penale, tani vazhdojnë të jetojnë në shtëpinë e tyre të përbashkët së bashku me tre fëmijët e tyre.

Gjyqtari i vetëm gjykues pas pranimit të fajësisë nga i pandehuri, marrjes në konsideratë të pikëpamjeve të prokurorit të shtetit, të dëmtuarës, si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës, vërteton se në veprimet inkriminuese të pandehurit të ndërmarra në kuadër të dashjes së tij, manifestohen të gjitha elementet qenësore të figurës së veprës penale në vazhdimësi "Dhuna në familje" nga neni 248 par. 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, andaj pasi që më parë gjeti se në aspektin penalo-juridik është përgjegjës, të njëjtin e shpall fajtor dhe i shqiptoi sanksionin penal si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjyqtari i vetëm gjykues mori parasysh të gjitha rrethanat e mundshme lehtësuese dhe ato rënduese të parapara me nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, të cilat janë me ndikim me rastin e marrjes së vendimit, ashtu që si rrethana lehtësuese morri parasysh pranimin e fajësisë në mënyrë të sigurtë nga i pandehuri, keqardhjen e shprehur për veprimet e tij, kërkim faljen, premtimin se në të ardhmen nuk do të përsëris veprën penale, tani me të dëmtuarën bashkëshorten e tij janë pajtuar dhe jetojnë në një shtëpi të përbashkët së bashku me fëmijët e tyre, janë zotuar se do të bëjnë përpjekje për t'i evituar situatat konfliktuoze, është i gjendjes së dobët ekonomike, përfitues i skemave sociale sipas kartelës së ndihmës sociale të lëshuar nga Q...-P., në emër të tani të dëmtuarës (bashkëshortes se tij), të lëshuar me datë 13.04.2021, me numër të regjistrimit ..., ndërsa rrethana rënduese nuk gjeti, andaj mbi bazën e arsyeve dhe rrethanave të sipër theksuara gjykata vlerësoi se dënimi me kusht si dënim alternativ i shqiptuar të pandehurit, është adekuat dhe në proporcion me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të tij, me bindje se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit me kusht i paraparë me nenin 47 të KPRK-së, i cili konsiston në risocializimin e të pandehurit me anë të pezullimit të dënimit, me të cilin dënim të pandehurit seriozisht i tërhiqet vërejtja dhe i bëhet me dije se nëse i njëjti kryen veprë tjetër penale brenda periudhës së verifikimit, gjykata do të revokojë dënimin me kusht dhe do të urdhërojë ekzekutimin e dënimit të caktuar në dënimin me kusht.

Vendimi mbi mundësinë e revokimit të dënimit me kusht është marrë në bazë të nenit 50 të KPRK-së.

Vendimi mbi lirimin e të pandehurit për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale është marrë në bazë të nenit 452 par. 4 të KPP-së.

Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest të rregullt juridiko civil është marrë në bazë të nenit 462 par. 2 të KPP-së.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të neneve 242 dhe 364 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË  
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal  
P.nr. 10/24, dt. 07.02.2024

Procesmbajtëse  
Erblina Aliu

Gjyqtari i vetëm gjykues  
Besnik Sheqiri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë e nëpërmes kësaj Gjykate.